

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Bazat e Auditimit të
Brendshëm
Internal Audit Basics**

B2

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 25/06/2022

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

1. Definicioni i auditimit të brendshëm nga Instituti Ndërkombëtar i Auditorëve të Brendshëm (IIA) thekson efektivitetin e cilës nga të mëposhtmet?
 - A. Pohimeve të vlerës, kostos dhe përfitimeve.
 - B. Rrezikut të vetvetishëm, rrezikut të mbetur dhe rrezikut total.
 - C. Qëllimi, natyra dhe fushëveprimi i punës.
 - D. Proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.**
2. Cila nga të mëposhtmet adreson individët që kryejnë punën e auditimit të brendshëm?
 - A. Standardet e performancës të Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA).
 - B. Standardet e veçorive të Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA).**
 - C. Standardet e zbatimit të Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm (IIA).
 - D. Standardet e palëve të treta.
3. Sipas Standardeve Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet), shefi ekzekutiv i auditimit duhet të përcaktojë qëllimet që kanë dy cilësi themelore. Zgjidhni tiparet e sakta të objektivave të auditimit të brendshëm:
 - A. Të buxhetuara dhe miratuara.
 - B. Të planifikuara dhe të arritshme.
 - C. Të kërkuara dhe të miratuara.
 - D. Të matshme dhe të arritshme.**
4. Të gjithë akterët e mëposhtëm pranojnë rezultatet e vlerësimit të programit të cilësisë së brendshme dhe të jashtme të aktivitetit të auditimit të brendshëm nga shefi ekzekutiv i auditimit, përveç:
 - A. Menaxherëve të lartë.
 - B. Menaxherëve funksional.**
 - C. Auditorëve të jashtëm.
 - D. Bordit të drejtorëve.
5. Sipas Standardit të Planifikimit, termi “oreksi i rrezikut” nënkupton cilën nga të mëposhtmet?
 - A. Pranimin e rrezikut.**
 - B. Shmangien e rrezikut.
 - C. Kufizimin e rrezikut.
 - D. Shpërndarjen e rrezikut.
6. Hartat e sigurisë kërkohen sipas cilave nga standardet e mëposhtmet?
 - A. Planifikimit.
 - B. Koordinimit.**
 - C. Menaxhimit të burimeve.
 - D. Kontrollit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

7. Komunikimi i qartë i fushëveprimit përfshirës dhe përjashtues në vlerësimin e rrezikut të auditimit, planin e auditimit të brendshëm dhe angazhimin në auditim, mund të zvogëlojë rrezikun nga cila prej të mëposhtmeve?
- A. Rrezikun e biznesit.
 - B. Dështimin e auditimit.
 - C. Sigurinë e rreme (e pavërtetë) të auditimit.**
 - D. Rrezikun e reputacionit të auditimit.
8. Kur një organizatë është e përfshirë në një varg riparimit financiar dhe hetime rregullative, kjo do të ndikonte negativisht cilën nga të mëposhtmet?
- A. Biznesi rrezikohet.
 - B. Dështimet e auditimit.
 - C. Sigurinë e rrejshme e auditimit.
 - D. Reputacioni i auditimit rrezikohet.**
9. Sipas Standardeve Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet), cila nga të mëposhtmet NUK është e përfshirë në fushëveprimin e funksionit të auditimit të brendshëm?
- A. Vlerësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të operacioneve dhe programeve.
 - B. Rishikimi i mjeteve për ruajtjen e pasurive.
 - C. Rishikimi i procesit të menaxhimit strategjik, vlerësimi i cilësisë së vendimmarrjes menaxheriale, si në aspektin sasior po ashtu edhe cilësor, si dhe raportimi i rezultateve tek komiteti i auditimit.**
 - D. Pajtuëshmëria me ligjet, rregulloret, politikat, procedurat dhe kontratat.
10. Programi i sigurimit të cilësisë i departamentit të auditimit të brendshëm ofron siguri të arsyeshme që puna e auditimit përputhet me standardet e aplikueshme. Cilat nga aktivitetet e mëposhtme është e dizajnuar për të ofruar reagim (feedback) lidhur me efektivitetin e departamentit të auditimit?
- I. Mbikëqyrja e duhur.
 - II. Trajnimi i duhur.
 - III. Rishikimet e brendshme.
 - IV. Rishikimet e jashtme.
- A. I, II, dhe III.
 - B. I, III, dhe IV.**
 - C. II, III, dhe IV.
 - D. I, II, III, dhe IV.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

11. Auditimi i brendshëm është unik për faktin se fushëveprimi i tij shpesh përfshin të gjitha fushat e një organizate. Si rrjedhojë, nuk është e mundur që secili auditor i brendshëm të ketë kompetencë të detajuar në të gjitha fushat që mund të auditohen. Cila nga kompetencat vijuese kërkohet nga Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet) për çdo auditor të brendshëm?

A. Tatimet dhe ligjet, ashtu siç zbatohen për funksionimin e organizatës.

B. Kompetencë në parimet e kontabilitetit.

C. Kompetencë në sistemet kompjuterike dhe bazat e të dhënave.

D. Kuptimi i parimeve të menaxhimit.

12. Së fundi, një ekip i auditimit të brendshëm përfundoi auditimin e pajtueshmërisë së kompanisë me politikën e saj të marrjes me lizing kundrejt blerjes në lidhje me automjetet e kompanisë. Raporti i auditimit vuri në dukje se bazat për disa vendime për marrje me lizing në vend të blerjes së automobilave, nuk janë dokumentuar dhe nuk ishin të auditueshme. Raporti përmbante rekomandimin që menaxhmenti operativ të sigurojë që marrëveshjet e tilla të lizingut të mos ekzekutohen pa dokumentacionin e duhur të bazës për vendimin për marrje me lizing në vend të blerjes. Auditorët e brendshëm janë të gatshëm të kryejnë punën pasuese (follow-up) për këtë raport të auditimit.

Qëllimi kryesor për kryerjen e rishikimit pasues (follow-up review) është të:

A. Sigurohet shqyrtimi në kohë i rekomandimeve të auditorit të brendshëm.

B. Lejoj auditorët e brendshëm të vlerësojnë efektivitetin e rekomandimeve të tyre.

C. Konstatoni se është ndërmarrë veprimi i duhur për gjetjet e raportuara.

D. Dokumentoj se çfarë po bën menaxhmenti në përgjigje të raportit të auditimit dhe të mbyll skedarin e auditimit në kohën e duhur.

13. Një auditor i brendshëm i papërvojë njoftoi auditorin senior për një variancë të konsiderueshme nga buxheti i të audituarit. Auditori senior i tha auditorit të ri të mos shqetësohej, pasi ai kishte dëgjuar se i audituari kishte pasur një ndërprerje të paautorizuar të punës që ndoshta kjo përbënte dallimin. Cila nga deklaratat e mëposhtme është më e përshtatshme?

A. Auditori i ri duhet ta kishte hetuar çështjen plotësisht dhe të mos e shqetësojë auditorin senior.

B. Auditori senior ka përdorur gjykimin adekuat për të kufizuar atë që mund të kishte qenë një hetim i kotë.

C. Auditori senior ishte dashur të ndalojë auditimin derisa varianca të jetë plotësisht e shpjeguar.

D. Auditori senior ishte dashur të ndihmojë auditorin e ri në formulimin e një plani për grumbullimin e evidencave të përshtatshme.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

14. Auditorët duhet të përcaktojnë nëse menaxhmenti ka vendosur kritere për të vlerësuar nëse qëllimet dhe objektivat janë përmbushur. Nëse auditori përcakton se kriteret e tilla janë të pamjaftueshme ose nuk ekzistojnë, cila nga veprimet e mëposhtme do të ishte e përshtatshme?
- I. Raportimi i mangësive tek niveli i duhur i menaxhmentit dhe rekomandimi i hapave të përshtatshme të veprimit.
 - II. Rekomandimi i burime alternative të kriterëve tek menaxhmenti, siç janë standardet e pranueshme të industrisë.
 - III. Formulimi i kriterëve që auditori beson se janë adekuate dhe kryen auditimin dhe raportimin në lidhje me kriteret alternative.
- A. Vetëm I.
B. Vetëm II.
C. I dhe II.
D. I, II dhe III.
15. Interpretimi i sigurimit të cilësisë të dhënë nga Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet) është që:
- A. Rishikimet e sigurimit të cilësisë mund t'i sigurojnë menaxhmentit të lartë dhe komitetit të auditimit një vlerësim të funksionit të auditimit të brendshëm.**
 - B. Aktiviteti ndjekës (follow-up) i duhur për një rishikim të jashtëm është përgjegjësi e mbikëqyrësit të menjëhershëm të shefit ekzekutiv të auditimit.
 - C. Departamenti i auditimit të brendshëm kryesisht matet kundrejt Kodit të Etikës.
 - D. Mbikëqyrja e vazhdueshme është e kufizuar në planifikimin, ekzaminimin, raportin e vlerësimit dhe procesin e aktivitetit ndjekës (follow-up).
16. Cilët nga dy komponentët kryesorë të paraqitura në vijim përfshihen në Kodin e Etikës?
- A. Përkufizimet e auditimit të brendshëm dhe direktivat administrative.
 - B. Parimet dhe rregullat e sjelljes.**
 - C. Integritetin dhe objektivitetin.
 - D. Konfidencialitetin dhe kompetencën.
17. Një Auditor i Brendshëm i Çertifikuar (ABC), i cili është duke u gjykuar nga Organizata profesionale sepse ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Etikës, do të jetë subjekt i:
- A. Pezullimi i thirrjes Auditor i Brendshëm i Çertifikuar (ABC) për një vit më e pakta.
 - B. Përfundimi i orëve shtesë të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP) për të mbajtur thirrjen Auditor i Brendshëm i Çertifikuar (ABC).
 - C. Pezullimin e thirrjes Auditor i Brendshëm i Çertifikuar (ABC) për një kohë të pacaktuar deri në rivendosjen e bordit.
 - D. Konfiskimi të thirrjes Auditor i Brendshëm i Çertifikuar (ABC).**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

18. Një auditor zbulon një mungesë të materialit në një funksion blerjeje. Menaxheri i blerjes është fqinji i afërt i auditorit dhe shoku më i mirë i tij. Në përputhje me Kodin e Etikës, auditori duhet:
- A. Të përfshijë faktet e rastit në mënyrë objektive në raportin e auditimit.**
 - B. Të mos e raportoj incidentin për shkak të besnikërisë ndaj mikut.
 - C. Të përfshij faktet e rastit në një raport të veçantë të paraqitur vetëm tek shoku i tij.
 - D. Të mos e raportoj shokun nëse aktiviteti nuk është i paligjshëm.
19. Objektiviteti i auditorit mund të rrezikohet në të gjitha situatat e mëposhtme, përveç:
- A. Në një konflikt interesi.
 - B. Në familjarizimin e të audituarit me auditorin për shkak të mungesës së rotacionit në angazhime.
 - C. Supozimeve të detyrave operacionale nga auditori në baza të përkohshme.
 - D. Mbështetjes në opinionin e një eksperti të jashtëm kur është e përshtatshme.**
20. Juve ju është kërkuar që të jeni anëtar i një ekipi rishikues të kolegëve (peer review). Gjatë vlerësimit të pavarësisë së departamentit të auditimit të brendshëm që po rishikohet, ju duhet t'i konsideroni të gjithë faktorët e mëposhtëm, përveç:
- A. Qasjes dhe frekuencës së komunikimit me bordin e drejtorëve ose komitetin e tij të auditimit.
 - B. Shkallës në të cilën auditorët marrin përgjegjësitë operative.
 - C. Kriteve të arsimimit dhe të përvojës që konsiderohen të nevojshme kur mbushen pozitat e lira në stafin e auditimit.**
 - D. Qëllimit dhe thellësisë së objektivave të auditimit për auditimet e përfshira në rishikim.
21. Kontrollat të cilat identifikojnë shmangiet nga standardet apo buxhetet dhe kërkojnë veprime korigjuese konsiderohen:
- A. Kontrollat paraprake
 - B. Kontrollat të ndërkohshme
 - C. Kontrollat pasuese**
 - D. Kontrollat zbuluese
22. Ju jeni mbikëqyrësi i auditimit dhe sapo jeni njoftuar se një punonjës kyç i auditimit nuk do të vijë në punë për disa javë për arsye shëndetësore. Si mbikëqyrësi i auditimit e ndryshoni kohën e kryerjes së punës së auditimit, në mënyrë që fusha për të cilën përgjigjej punonjësi që do të mungojë, të auditohet më parë. Ky veprim paraqet cilin lloj të kontrolleve:
- A. Kontrollat paraprake**
 - B. Kontrollat e ndërkohshme
 - C. Kontrollat pasuese
 - D. Kontrollat korigjuese

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

23. Cila nga kontrollet në vijim ndihmojnë në arritjen e sigurisë së burimeve të mbrojtura nga humbjet apo mashtrimet, ose edhe përvetësimet, dhe mbështesin arritjen e synimeve dhe objektivave të organizatës.
- A. Kontrollet administrative**
 - B. Kontrollet kontabël
 - C. Kontrollet operative
 - D. Kontrollet e sigurisë fizike
24. Cilat lloje të skedave përmbajnë disa funksione të rëndësishme të tilla si: të ekzekutimit, të kopjimit, të fshirjes, të shkruarjes që i nevojiten programeve të aplikimit, ose sistemit operativ, ose sistemeve të tjera mbështetëse të softuerit.
- A. Skedat e komandave**
 - B. Skedat për t'u shtypur
 - C. Skedat e përdoruesve
 - D. Skedat e raporteve
25. Cila nga pohimet e mëposhtme është (janë) e saktë (e sakta) në lidhje me parandalimin e mashtrimit?
- I. Mjeti kryesor për të ndaluar mashtrimin është përmes një sistemi efektiv kontrolli të iniciuar nga menaxhmenti i lartë.
 - II. Auditorët e brendshëm janë përgjegjës për të ndihmuar në parandalimin e mashtrimit duke ekzaminuar dhe vlerësuar përshtatshmërinë e sistemit të kontrollit.
 - III. Auditorët e brendshëm duhet të përcaktojnë nëse kanalet e komunikimit i ofrojnë menaxhmentit informacion të duhur dhe të besueshëm në lidhje me efektivitetin e sistemit të kontrollit dhe ndodhjen e transaksioneve të pazakonta.
- A. Vetëm I
 - B. I dhe II
 - C. Vetëm II
 - D. I, II dhe III**
26. Zakonisht departamenti i teknologjive informative përdor ofruesit e shërbimeve të palëve të treta, të tilla si kontraktorët. Menaxhmenti duhet të jetë i kujdesshëm për sa i takon elementeve që duhet të kontraktohen ose jo. Në vijim janë paraqitur një përmbledhje të kontrolleve parandaluese që kanë të bëjnë me shërbimet e ofruara nga palët e treta. Cila nga kontrollet e mëposhtme NUK është një kontroll parandalues?
- A. Kontrata ligjore me nene për të drejtën për t'u audituar
 - B. Propozime pune me rezultate të qarta dhe të matshme
 - C. Ndërgjegjësimi për sa i takon mbrojtjes së të drejtave të autorit
 - D. Rishikimi dhe modifikimi periodik i kontratave**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

27. Një kompani me një linjë telefonike për raportimin e sjelljeve jo etike ka pranuar një raportim anonim se tre auditorë të brendshëm janë duke shkelur Kodin e Etikës. Kompania ka adoptuar Kodin e Etikës si një pjesë të kodit të tij etik të korporatave. Ndër akuzat kundër auditorëve ishin këto:

Auditori 1 ka një punë me kohë të pjesshme jashtë orarit të punës si profesor vizitues në një kolegji të komunitetit lokal.

Auditori 1 zotëron aksione në kompaninë punëdhënëse.

Auditori 1 i tha fqinjët të tij që të fillonte të kërkonte një punë të re sepse një auditim i zyrës ekzekutive tregoi që divizioni i fqinjët do të mbyllet brenda rreth gjashtë muajsh.

Auditori 2 pranoi një dhuratë me vlerë nga një organizatë lokale jofitimprurëse e agjentëve blerës për të cilët mbajti një fjalim.

Auditori 2 ka marrë një dhuratë me vlerë nga një klient i punëdhënësit.

Auditori 2 ka një punë me kohë të pjesshme si president i një organizate bamirësie vendore.

Auditori 2 ka ndarë teknikat e auditimit me auditorët nga një kompani tjetër, ndërsa po merr pjesë në një takim profesional.

Një blerës pranoi para në vlerë prej €500 për t'i dhënë shumat e ofertës një furnizuesi për t'i mundësuar atij furnizuesi të ofrojë kontratën. Auditori 2 nuk e ka cekur këtë informacion në raportin e auditimit pasi që shumat e kontratës nuk ishte e rëndësishme për pasqyrat financiare.

Auditori 3 mori honorare nga një botues për autorizimin e një libri profesional për auditimin e brendshëm.

Auditori 3 ka një punë me kohë të pjesshme si një ndërmjetës i pasurive të patundshme, dhe firma e tij e pasurive të patundshme kohët e fundit mori një komision nga kompania e punëdhënësit.

Auditori 3 ka marrë një dhuratë me vlerë nga një bashkëpunëtor në të njëjtën kompani, departamenti i të cilit nuk është audituar kurrë dhe departamenti i të cilit nuk është planifikuar të auditohet në të ardhmen e parashikueshme.

Auditori 3 nuk përfshiu në një raport të auditimit që pengesat në një departament transporti janë shkaktuar nga mungesa e mbikëqyrësit. Mbikëqyrësi ishte miku dhe fqinji i auditorit, i cili kishte një fëmijë të shtruar në spital, që e bërë atë të mungojë në punën dhe për disa javë.

Sa prej pretendimeve për Auditorin 1 paraqesin shkelje të Kodit të Etikës?

A. Asnjë

B. Një

C. Dy

D. Tri

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

28. Gjatë një auditimi të rregullt të planifikuar të një divizioni të madh të teknologjisë së informacionit (IT), auditori i IT zbulon një algoritëm të ndërlikuar programimi që shton kosto në një program kosto-plus që faturon qeverinë. Shuma e shtuar zinte 95% të të ardhurave neto të divizionit për vitin e fundit. Pas hetimit të mëtutjeshëm, auditori i IT zbulon se vetëm menaxheri i marketingut, menaxheri i divizionit të IT dhe programuesi kanë njohuri rreth algoritmit.

Kompania ka një divizion të veçantë për të hetuar mashtrimin. Auditori komunikon me menaxhmentin dhe divizionin e veçantë të hetimit të mashtrimit, dhe hetimi i dorëzohet atij grupi. Megjithatë, pas një muaji, bëhet e qartë se menaxhmenti i lartë ka udhëzuar grupin e hetimit që të mos hetoj më tutje. Departamenti i auditimit të brendshëm duhet:

- A. Raportoj menjëherë rrethanat dhe gjetjet e auditorit IT në agjencinë e duhur rregullatorë. qeveritare sepse auditori nuk mundet me vetëdije të jetë palë e një akti të paligjshëm.
- B. Mos ndërmer asnjë veprim tjetër. Natyra e mashtrimit është raportuar tek autoritetet e duhura brenda kompanisë dhe auditori nuk ka fuqi të ndjekë hetimet më tej.
- C. Raportoj menjëherë rrethanat dhe gjetjet e auditorit IT tek komiteti i auditimit.**
- D. Raportoj gjetjet tek auditori i jashtëm sepse auditori i jashtëm duhet të jetë i vetëdijshëm për ndonjë keq-deklarim material të bilancit të llogarisë.

29. Një kompani punësoi një menaxher të llogarive të pagueshme të mbi kualifikuar të cili i' u ishte ndërprerë kontrata nga një kompani tjetër për dyshime për keq bërje. Gjashtë muaj më vonë menaxheri devijoi €12,000 duke dërguar pagesa të kopjuara të faturave të një i afërm. Një kontroll që mund të kishte parandaluar këtë situatë do të ishte:

- A. Kontrolloni si duhet historikun e mëparshme të punësimit për të gjithë punonjësit e rinj.**
- B. Mos punësoni individë që paraqiten të mbi kualifikuar për një vend pune.
- C. Verifikoni kualifikimin arsimor për të gjithë punonjësit e rinj.
- D. Kontrolloni për të parë nëse të afërmit e të punësuarit punojnë për shitësit.

30. Menaxhimi me libra të hapur i lejon punonjësve të shohin vetë - nëpërmjet listave, materialeve të shtypura, takimeve, dhe raporteve - gjendjen financiare të kompanisë. Ai gjithashtu i' u tregon punonjësve individualë se si puna e tyre përshtatet me pamjen e tërë organizatës dhe se si puna në fjalë ndikon në të ardhmen financiare të organizatës. Qëllimi i menaxhimit me libra të hapur është që:

- A. secili punonjës të fillojë të mendojë si të ishte pronar i biznesit dhe jo si një i punësuar që nuk e di se nga vijnë e ku shkojnë paratë.**
- B. të vlerësojë nëse shpenzimet bëhem më shumë për aktivitetet që i shtojnë vlerë apo ato që nuk shtojnë vlerë kompanisë.
- C. të tregoj se sa mirë janë duke u menaxhuar burimet dhe kapitali njerëzor për të ardhmen e kompanisë.
- D. menaxhmenti të përqendrohet në reduktimin e kostove që kanë të bëjnë me aktivitetet që nuk shtojnë vlera.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

31. Të punuarit nga shtëpia dhe politikat e organizatës për piraterinë softuerike mund të jetë në konflikt me njëra - tjetrën në qoftë se një person i cili punon nga shtëpia (dhe jo në zyrë) nuk i zbaton politikat e tilla ose i zbaton ato në mënyrë të papërshtatshme dhe kur blen ose shkarkon softuerë të paautorizuar në kompjuter. Ky rast paraqet shembull të:

- A. Kontrolleve kontradiktore**
- B. Kontrolleve kompensuese
- C. Kontrolleve plotësuese
- D. Kontrolleve manuale

32. Skedat e pezullimeve, Testet e marrëdhënieve, Leximet përshkruese prapsht, Kontrolltet e të dhënave dhe Verifikimet e elementeve kyçe janë shembuj të kontrolleve të cilat kanë të bëjnë me operacionet e teknologjive informative dhe i takojnë grupit të kontrolleve:

- A. Kontrolleve parandaluese
- B. Kontrolleve zbuluese**
- C. Kontrolleve korigjuese
- D. Kontrolltet mbi qasjet e njëkohshme

33. Menaxhmenti i një banke dyshon se një zyrtar i kredive kohëve të fundit krijonte kredi për kompani fiktive, ka arkëtuar shumat e kredive në llogarinë personale, dhe duke lënë kështu kreditë si borxhe të papaguara në kohë. Disa fakte përkatëse në lidhje me zyrtarin e kredisë përfshijnë:

- Një standard i lartë jetese, i shpjeguar si rezultat i investimeve të shëndosha dhe mos marrjes së pushimeve.
- Një veturë e shtrenjtë personale e marrë përmes kontakteve të biznesit.
- Faturat e benzinës dhe të riparimit të paraqitura për një makinë të caktuar të kompanisë që janë më të larta se mesatarja e kompanisë (regjistrat e kilometrazhit u dorëzuan në baza tremujore).
- Potenco i se bezdiset me pyetjet e auditorëve.

Shkalla e kredive të lëshuara për huamarrësit fiktiv nga zyrtari i kredisë mund të përcaktohet më së miri nga:

- A. Rishikimi i një mostre përfaqësues të transaksioneve të zyrtarit të kredisë për pajtueshmërinë me politikat dhe procedurat bankare.
- B. Rishikimi i një mostre përfaqësues të dosjeve të kredisë për dokumentet e plotësuar, të tilla si marrëveshjet e kredisë, miratimet e kredisë dhe miratimi i kolateralit të siguruar.**
- C. Krahasimi i bilanceve të kredive aktuale të miratuara me ato të viteve të mëparshme.
- D. Kërkoni konfirmime pozitive për të gjitha kreditë e papaguara të bëra nga zyrtari i kredisë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

34. Vetë - vlerësimet e kontrollit (CSA) trajtojnë vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në të gjitha organizatat. Vetë - vlerësimet e kontrollit janë një përgjegjësi e përbashkët që i takon të gjithë punonjësve të entitetit, jo vetëm auditimit të brendshëm apo menaxhimit të lartë. Cila nga opsionet e mëposhtme përfshinë të gjitha elementet e vetë - vlerësimeve të kontrollit?

- I. Planifikimi paraprak dhe puna paraprake e auditimit
- II. Mbledhja e pronarëve të procesit me një trajnues
- III. Një agjendë e strukturuar për të shqyrtuar rreziqet e procesit dhe kontrollet për të
- IV. Një mbajtës i shënimeve dhe teknologjia elektronike e votimeve për të mbledhur komentet dhe opinionet e dhëna
- V. Raportimi i rezultateve dhe zhvillimi i planeve të veprimeve korrigjuese.

- A. I, II, V
- B. I, III, IV dhe V
- C. I, III, IV
- D. I, II, III, IV dhe V**

35. Menaxhmenti i një kompanie sigurimi të pronave dhe shëndetit është e shqetësuar për efikasitetin dhe efektivitetin e aktiviteteve të përpunimit të kërkesave. Menaxhmenti ka dy shqetësime kryesore: (1) Janë paguar disa kërkesa që nuk duhet të paguhen ose janë paguar në shuma që tejkalojnë politikën e kompanisë; dhe (2) shumë paditës nuk janë paguar në kohën e duhur. Në përgatitjen e një auditimi të kësaj fushe, auditori i brendshëm vendos të kryejë një studim paraprak për të mbledhur më shumë informacion rreth natyrës së përpunimit të kërkesave dhe problemeve të mundshme.

Cila nga procedurat vijuese do të ishte më pak efektive në mbledhjen e informacionit në lidhje me natyrën e përpunimit të kërkesave dhe problemet potenciale?

- A. Intervistimi i mbikëqyrësve në departamentin e kërkesave për të mësuar më shumë për procedurat e përdorura dhe arsyetimin e tyre si dhe për të marrë vërejtjet e tyre për natyrën dhe efikasitetin e përpunimit të kërkesave.
- B. Intervistimi i punonjësve të zgjedhur zyrtar në departamentin e kërkesave për të gjetur më shumë rreth procedurave të përdorura dhe arsyetimin e procedurave dhe për të marrë vërejtjet e tyre për natyrën dhe efikasitetin e përpunimit.
- C. Dërgimi i një mesazhi me postë elektronike tek i tërë personeli zyrtar që detajon problemet e pretenduara dhe të kërkoi nga ata që të përgjigjen.**
- D. Shpërndarja e një pyetësori për të kuptuar më mirë përgjegjësitë për përpunimin e kërkesave dhe procedurat e kontrollit të përdorura.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

36. Cila nga opsionet e mëposhtme përshkruan më së miri disavantazhin më të madh të përdorimit të një pyetësi dhe jo të një diagrami rrjedhës (flowchart) për të vlerësuar kontrollet e brendshme?
- A. Pyetësit zakonisht marrin më shumë kohë për t'u përgatitur dhe janë më të pavolitshëm.
 - B. Përgjigjet nuk alarmojnë (tregojnë, shënojnë) në mënyrë efektive dobësitë e mundshme të kontrollit të brendshëm.
 - C. Është e vështirë për auditorët të zhvillojnë ose të sigurojnë pyetësorë që janë të përshtatshëm për shumicën e sistemeve të kontrollit të brendshëm.
 - D. Auditorët mund të plotësojnë pyetësorët pa i kuptuar në të vërtetë operacionet e përgjithshme të sistemeve të kontrollit të brendshëm.**
37. Nëse një auditor është duke marrë mostrën për të testuar pajtueshmërinë me një politikë të caktuar të kompanisë, cili nga faktorët e mëposhtëm NUK ndikon në nivelin e lejuar të rrezikut të mostrimit?
- A. Përvoja dhe njohuritë e auditorit.**
 - B. Pasojat negative të papajtueshmërisë.
 - C. Niveli i pranueshëm i rrezikut për të nxjerrë një përfundim të gabuar të auditimit.
 - D. Kostoja e kryerjes së procedurave të auditimit në përzgjedhjen e mostrave.
38. Një auditor përzgjedhi një mostër të rastësishme prej 100 artikujsh nga një popullatë prej 2000 artikujsh. Totali i përgjithshëm në euro i mostrës ishte 10,000€ dhe devijimi standard ishte 10€. Nëse saktësia e arritur bazuar në këtë mostër ishte plus ose minus 4,000 euro, vlera minimale e pranueshme e popullatës do të ishte:
- A. 204,000€.
 - B. 196,000€.**
 - C. 199,000€.
 - D. 199,800€.
39. Një auditor po konsideron një madhësi të mostrës prej 50 faturave për të vlerësuar shumën mesatare për faturë në një kompani të madhe kamionësh. Si do të ndikohej saktësia e rezultateve të mostrës nëse madhësia e mostrës do të rritet në 200?
- A. Mostra më e madhe do të ishte rreth dy herë më e saktë sesa mostra më e vogël.**
 - B. Mostra më e madhe do të ishte rreth katër herë më e saktë sesa mostra më e vogël.
 - C. Megjithatë saktësia nuk do të rritet aq shumë, do të korrigjohej një rënie e mundshme në vlerësimin e mesatares për faturë.
 - D. Meqë të dy madhësitë e mostrës janë më të mëdha se 30, rritja nuk do të kishte shumë ndikim në saktësi.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

40. Një ekip auditimi është caktuar për të shqyrtuar sistemin e matjes së kënaqësisë së klientit që një departament i produkteve industriale e ka implementuar dy vite më parë. Ky sistem përbëhet nga zyra e departamentit të shërbimeve për klientë që realizon një anketim vjetor përmes postës. Anketa i dërgohet 100 departamenteve të blerjeve të përzgjedhura rastësisht nga të gjithë konsumatorët që kanë bërë blerje në 12 muajt e mëparshëm. Anketa është tre faqe e gjatë dhe 30 pyetjet e saj përbëhen nga një përzierje e mënyrave të përgjigjes (p.sh. disa pyetje janë të hapura, disa me zgjidhje të shumëfishta dhe të tjerat përdorin një shkallë përgjigjesh). Zyra e shërbimit për klient e dërgon anketën në shtator dhe i paraqet në mënyrë tabelare rezultatet nga pyetësi deri më 15 tetor. Vetëm një email dërgohet. Nëse konsumatori nuk i përgjigjet pyetësorit, nuk ridërgohet edhe një herë pyetësi si rikujtim për plotësim. Herën e fundit kur anketa u krye, 45 nga pyetësit nuk u kthyen mbrapa.

Cila nga të mëposhtmet NUK është një avantazh i intervistave ballë për ballë kundrejt anketave përmes postës?

- A. Shkalla e përgjigjes është zakonisht më e lartë.
- B. Intervistuesit mund të rrisin kuptueshmërinë e përgjigjeve të të anketuarit ndaj pyetjeve të bëra.
- C. Dizajnerët e anketimit mund të përdorin një shumëllojshmëri më të gjerë të llojeve të pyetjeve.
- D. Ata janë më pak të shtrenjtë, pasi që shpenzimet e postës shmangen.**

41. Arsyeja kryesore për një auditor që të përdorë mostrat statistikore është:

- A. Siguron një mostër më të vogël se sa që do të kërkohej nga teknikat jostatistikore të mostrimit.
- B. Siguron një mostër që është më përfaqësuese e popullatës se sa që do ta sigurate nga teknikat jostatistikore të mostrimit.
- C. Përmbushë kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet).
- D. Lejon auditorin të kuantifikojë (përcaktojë sasinë) dhe kështu të kontrollojë rrezikun e marrjes së një vendimi të pasaktë bazuar në evidencën e mostrës.**

42. Gjatë testimit të transaksioneve të listës së pagave, një auditor zbulon se katër nga një mostër statistikore prej 100 kartash kohore (listat e vijueshmërisë) të zgjedhura nuk janë nënshkruar nga mbikëqyrësi i duhur. Për të vlerësuar materialitetin ose rëndësinë e kësaj mangësie të kontrollit, auditori duhet të:

- A. Krahasojë shkallën e tolerancës së gabimit me normën e pritur të gabimit.
- B. Vlerësojë shumën në euro të katër kartave të kohës (listave të vijueshmërisë) në lidhje me pasqyrat financiare.
- C. Llogarit një kufi më të lartë të saktësisë dhe të krahasojë atë me gabimin e tolerueshëm.**
- D. Raportoje gabimet dhe të lejoj menaxhmentin të vlerësojë rëndësinë, sepse ata janë në pozitën më të mirë për ta ditur.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

43. Një mostër nga një popullatë prej mbi 10,000 faturash të ngarkimit është e nevojshme për të vlerësuar një shkallë gabimi. Meqenëse një madhësi e mostrës prej 250 do të kënaq nevojat e saktësisë dhe nivelit të besimit, është zgjedhur një interval mostrimi prej 40. Për lehtësinë e zbatimit, auditori zgjedh rastësisht një numër midis 1 dhe 40 dhe pastaj zgjedh çdo të 40-in artikull pasues. Cila nga të mëposhtmet është e vërtetë?
- A. Mostrës i mungon rastësia dhe nuk do të jetë e saktë.
 - B. Mostrat e intervaleve nuk janë një metodë e pranueshme statistikore.
 - C. Nëse popullatës i mungon anësia (nuk anon nga një njësi e caktuar apo vlerë e caktuar), mostra është statistikisht e vlefshme.**
 - D. Mostra e intervaleve eliminon përdorimin e gjykimit të auditorit.
44. Një auditor i brendshëm dyshon se faturat nga një numër i vogël i furnitorëve përmbajnë gabime serioze dhe për këtë arsye kufizon mostrën vetëm për ata furnitorë. Disavantazhi kryesor i zgjedhjes së një mostre të tillë të artikujve për t'u shqyrtuar është:
- A. Vështirësia e sigurimit të artikujve të mostrës.
 - B. Mungesa e një shpërndarje normale.
 - C. Tendenca për të mostruar një numër më të madh të njëjësive.
 - D. Pamundësia për të kuantifikuar gabimin e mostrimit në lidhje me popullatën e përgjithshme të faturave nga furnitorët.**
45. Një auditor dëshiron të përcaktojë nëse shkalla e gabimit në kërkesat e rimbursimit për udhëtime është brenda nivelit të tolerancës prej 5% të përcaktuar nga menaxhmenti. Cilin plan të përzgjedhjes së mostrës duhet të përdorë auditori?
- A. Përzgjedhja e mostrave sipas variablave (ndryshoreve).
 - B. Përzgjedhja e mostrave sipas veçorive.**
 - C. Përzgjedhja e mostrave duke u bazuar në gjykim.
 - D. Përzgjedhja e mostrave në njësi euro.
46. Auditori i brendshëm përdor një numër teknikash për të zgjedhur mostrat. Një teknikë e përdorur shpesh dhe e përshtatshme, është përzgjedhja e rastësishme. Në cilën nga situatat e mëposhtme do të ishte përzgjedhja e rastësishme më pak e justifikuar? Auditorit i duhet të:
- A. Testoj transaksionet e shitjes për të përcaktuar se ato ishin të autorizuara siç duhet dhe mbështeten nga dokumentet e transportit.
 - B. Konfirmoj llogaritë e arkëtueshme dhe tashmë ka zgjedhur 10 llogaritë më të mëdha për konfirmim. Llogaritë e mbetura nuk numërohen. Auditori ka vetëm një listë kompjuterike të llogarive në mënyrë alfabetike të gjatë rreth 250 faqe me 50 saldo të llogarive në çdo faqe.
 - C. Siguroj prova për ndërprerjen (cutoff) e duhur të shitjes duke marrë mostra nga ditaret e shitjeve mujore për të përcaktuar nëse artikujt janë regjistruar në periudhën e duhur kohore.**
 - D. Testoj regjistrimet e stokeve të përhershme për të siguruar që mostra mbulon vlerat më të mëdha të artikujve në euro në llogari.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

47. Në një aplikacion të mostrimit sipas variablave (ndryshoreve), cili nga faktorët e mëposhtëm do të ndryshojë drejtpërdrejtë me një ndryshim në nivelin e besueshmërisë nga 90% në 95%?
- A. Gabimi standard i mesatares.
 - B. Gabim i mos-mostrimit.
 - C. Precizioni (përpikëria) i arritur.**
 - D. Vlerësimi i pikës së mesatares aritmetike.

48. Është kryer një auditim i inventarit të një kompanie që bën shitje me shumicë për të vlerësuar vlerën e saj. Inventari përmbante 20,000 artikuj me një vlerë në libra prej 1 milion euro. Plani i auditimit ishte të vlerësonte vlerën e inventarit me një saktësi prej $\pm 2\%$ në një nivel besueshmërie prej 90%. Rezultatet e mostrës ishin:

Madhësia e mostrës: 300

Mesatarja e mostrës për njësi: 52€

Devijimi standard i mostrës për njësi: 10.80€

Saktësia e mostrës për njësi: 1.03€

Bazuar në rezultatet e mostrës, vlera e vlerësuar e inventarit është ndërmjet:

- A. 784,000 € dhe 1,216,000€.
 - B. 844,000 € dhe 1,256,000€.
 - C. 1,019,400 € dhe 1,060,600€.**
 - D. 979,400 € dhe 1,020,600€.
49. Një auditor po teston mbi një kartelë të madhe të llogarive të arkëtueshme të një kompanie. Objektivat e auditimit janë të testojnë saldot në euro në fund të periudhës dhe normat e përjashtimit (gabimit) të regjistrimeve të të arkëtueshmeve. Konto e llogarive të arkëtueshme përmban një numër të madh të saldove të shumave të vogla në euro dhe një numër të vogël të saldove në shuma të mëdha në euro dhe auditori pret të gjejë gabime të shumta në saldot e llogarive. Teknika më e përshtatshme e përzgjedhjes së mostrave për të vlerësuar sasinë e gabimeve në euro do të ishte:
- A. Diferenca ose vlerësimi i koeficientëve.**
 - B. Diferenca e pabazuar për njësi.
 - C. Probabiliteti proporcional me madhësinë.
 - D. Veçoria.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

50. Duke përdorur përzgjedhjen e mesatares së mostrës për njësi për të vlerësuar vlerën e stoqeve, një auditor kishte rezultatet e mëposhtme:

Vlera e parashikuar e stoqeve	Niveli i besueshmërisë	Intervali i besueshmërisë	Gabimi standard (Devijimi standard /)	Vlera Z (përafërsisht)	Saktësia
3,000,000 €	95%	2,800,000 € - 3,200,000 €	100,000 €	2.0	200,000€

Vlera e regjistruar e stoqeve ishte 3,075,000€. Gabimi standard prej 100,000€ reflekton në:

- A. Gabimin e parashikuar të popullatës bazuar në gabimet në mostër.
- B. Shkalla mesatare e gabimit në mostër.
- C. Shkalla e ndryshueshmërisë në shumën në euro të artikujve mostër.**
- D. Gabimi i popullatës që auditori mund të pranojë.